



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA
KOSOVA CADASTRAL AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA

Nr./Br: 01/298/20

Nr./Iq./Br.let: _____

Data/Datum: 02-03-2020

PRISHTINË-PRISTINA



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-476/20

Data/Date/Datum 02-03-2020

PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

DHE

POSTËS SË KOSOVËS SH.A

PËR

SHFRYTËZIMIN DHE SHPËRNDARJEN E ADRESAVE

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëposhtëm – AKK e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti) dhe

Posta e Kosovës (Posta e Kosovës SH.A me numër të regjistrimit të biznesit Nr.811285205 e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv Shefqet Avdija) lidhin këtë marrëveshjen e bashkëpunimit si ne vijim, në tekstin e mëposhtëm

Neni I

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit ka për qëllim bashkëpunimin në mes të AKK-së dhe Postes së Kosovës rreth shfrytëzimit dhe shpërndarjes së të dhënave të Adresave zyrtare. Në bazë të nevojave të institucioneve tona për bashkëpunim dhe shkëmbimin e të dhënave të adresave, është paraqitur nevoja për bashkëpunim dhe shkëmbim të të dhënave ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Postës së Kosovës (Posta). Posta si Ndërmarrje Publike Qendrore, ka për qëllim që të ofrojë shërbime postare dhe shërbime tjera komerciale për qytetarët, bizneset, institucionet dhe organizatat e ndryshme në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar. Në ofrimin e shërbimeve postare ndikim të madh luajnë edhe adresat, prandaj bazuar në diskutimet paraprahe është shumë e nevojshme bashkëpunimi në mes AKK-së dhe Postës së Kosovës rreth ofrimit e të dhënave të adresave zyrtare që posedon AKK dhe shfrytëzimin e të dhënave të adresave zyrtare nga Posta. Gjithashtu shumë me rëndësi është edhe roli i Postës së Kosovës rreth informimit të të dhënave të adresave zyrtare tek qytetarët, bizneset, institucionet dhe organizatat e ndryshme. Në këtë mënyrë mundësohet shfrytëzimi i Sistemi Zyrtar i Unifikuar i Adresave.

Neni II

Përdorimi i të dhënave

1. Përdorimi i të dhënave do të mundësohet vetëm për lexim (read only) dhe do të jetë i qasshëm vetëm nga përdoruesit e autorizuar nga të dy palët.
2. AKK dhe Posta do të krijojnë një grup punues të përbashkët i cili do të merret me aktivitetet rreth përmbushjes së detyrimeve që dalin nga kjo marrëveshje.

Neni III

Përgjegjësitë/obligimet e AKK-së

1. AKK do të inicioj formimin e Grupit Punues të përbashkët me zyrtar të Postes së Kosovës;
2. AKK do të koordinoj aktivitetet e grupit punues së bashku me Postën e Kosovës;
3. AKK do të fus në sistemin ARIS të dhënat grafike të Zonave Postare;
4. AKK do të ofroj bazën e të dhënave të adresave nga Sistemi i Informacionit të Regjistrimit të Adresave;
5. AKK do të ofroj mbështetjen profesionale dhe teknike rreth Sistemit të Adresave që ndërlidhen me pilot projektin;
6. AKK obligohet të ruaj fshehtësinë e çfarëdo lloji të dhënave të shkëmbyera sipas ligjeve në fuqi;
7. AKK për shërbimin e shpërndarjes së adresave do të kompensoi shërbimin Postes së Kosovës varësisht prej llojit të dërgesës të thjeshtë apo R (rekomandë) për dërgese sipas tarifave të ARKEP që i përdorë për palët Posta e Kosovës;

Neni IV

Përgjegjësitë/obligimet e Postës

1. Posta do të marr pjesë në grupin punues dhe të koordinoj aktivitetet së bashku me AKK-në;

2. Posta do të krijoj Zonat Postare në formatin grafike (formati shape file) për ti futur në Sistemin ARIS;
3. Posta do ti shfrytëzoj të dhënat zyrtare të ofruara nga AKK;
4. Posta do të ofroj mbështetje rreth shpërndarjes dhe informimit të të dhënave të adresave zyrtare;
5. Posta do të ofroj mbështetjen profesionale dhe teknike rreth shfrytëzimit dhe shpërndarjes së të dhënave të adresave;

Neni V
Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat që shkëmbehen në mes të AKK-së dhe Postës, nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni VI
Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

1. Ky memorandum lidhet për afat të pacaktuar;
2. Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale duhet të zgjidhen me konsultim dhe mirëkuptim në mes palëve;
3. Ky Memorandum mund të ndërpritet në çdo kohë nga cilado palë nënshkruese, në rast të mos përmbushjes apo shkeljes së përgjegjësive të përcaktuara;
4. Memorandumi mund të shkëputet në çdo kohë me një paralajmërim me shkrim, së paku një muaj para datës së ndërprerjes.

Neni VII
Hyrja në Fuqi

1. Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum Bashkëpunimi fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit nga palët;
2. Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, palët obligohen në zbatimin e plotë të dispozitave të tij.

Palët nënshkruese


 Avni Ahmeti
 Drejtor Ekzekutiv i AKK-së
 02.03.2020
 Data e nënshkrimit


 Shefqet Avdija
 Kryeshëf Ekzekutiv i Postës
 02.03.2020
 Data e nënshkrimit